

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7954
E martë, 17 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

GRENELLI PRAPA PORTËS

IFAQE 3



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI S'PARAQITET NË PROKURORINË SPECIALE PËR RASTIN E REZERVAVE SHTETËRORE

IFAQE 4-5



Kryeministri Albin Kurti ishte ftuar të hënën nga Prokuroria Speciale e Kosovës, që të intervistohet në cilësinë e dëshmitarit lidhur me një çështje penale që po hetohet

nga kjo prokurori. Kurti, për shkak të angazhimeve zyrtare jashtë vendit, nuk ishte i pranishëm në Prokurorinë Speciale. Megjithatë, kryeministri ka shprehur

gatishmërinë t'i presë prokurorët e rastit në zyrën e tij. Ndërkaq opozita e ka kritikuar kryeministrin Kurti për qasjen e tij karshi gjyqësorit dhe prokurorisë

KFOR-i HEDH POSHTË RAPORTIMET SE UA NDALOI ZYRTARËVE HYRJEN NË KOMUNËN E LEPOSAVIQIT

F. 3



KUVENDET E DY SHTETEVE KOSOVË - SHQIPËRI MBLIDHEN MË 20 DHJETOR

F. 5



INAUGUROHET ZYRA REGIONALE E AGJENCISË SË USHQIMIT DHE VETERINËS

F. 5

SPORT



GREEN, MVP I JAVËS NË SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shqipëria në janar do ta fillojë regjistrimin e diasporës për zgjedhjet e majit

TIRANË, 16 DHJETOR - Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Shqipëri, Ilirjan Celibashi, njoftoi të hënën se më 11 janar pritet të jetë funksionale platforma elektronike, ku rreth një milion mërgimtarë shqiptarë mund të regjistrohen për të votuar në zgjedhjet parlamentare në Shqipëri. Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri do të mbahen më 11 maj dhe diaspora shqiptare do të votojë për herë të parë në to. Duke raportuar para nënkomisionit të Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin, Celibashi theksoi se procesi i përgatitjes së votimit nga jashtë ka shkuar "sipas të gjitha

parashikimeve" me Kodin Zgjedhor. "Komisioni Rregullator pranë KQZ-së ka miratuar thauja të gjitha aktet kryesore me qëllim realizimin e votimit nga jashtë. Para Krishtlindjeve do të kemi një demonstrim të funksionaliteteve të këtij sistemi me qëllim që, më 11 janar, kjo platformë të jetë funksionale", tha Celibashi.

Kreu i KQZ-së tha se testet do të bëhen në prani të organizatave të huaja, shoqërisë civile, palëve politike dhe garanoi "100 për qind siguri" për këtë proces.

I pyetur nga deputetët nëse do të finalizohet ky proces para datës së zgjedhjeve, Celibashi tha se është "plotësisht e



realizueshme". Kuvendi i Shqipërisë miratoi në fund të korrikut disa ndryshime në Kodin Zgjedhor që

mundësojnë votën e emigrantëve. Vota do të dërgohet me postë dhe tarifa do të mbulohet nga

shteti shqiptar.

Celibashi tha se janë mbi një milion votues nga jashtë, por ngriti shqetësimin se një numri të madh imigrantësh u kanë skaduar dokumentet e identifikimit, ose mund t'u skadojnë ditën e zgjedhjeve. Ai kërkoi të merren masa nga qeveria shqiptare për ta shtyrë vlefshmërinë e këtyre dokumenteve sikurse ka ndodhur në zgjedhjet e vitit 2021. Sipas një raporti të Institutit të Statistikave në vitin 2020, numri i asaj që njihet si "diaspora e re", apo imigrantët e larguar gjatë viteve '90 nga Shqipëria, ka arritur në rreth 1.68 milionë.

BE-ja miraton sanksione të reja ndaj Ruisë, përfshin edhe entitete kineze

BRUKSEL, 16 DHJETOR - Bashkimi Evropian e ka miratuar pakon e 15 të sanksioneve ndaj Ruisë për pushtimin e Ukrainës, që përfshin masa më të ashpra ndaj entiteteve kineze dhe anijeve nga e ashtuquajtura e flotës "hije" të Moskës, tha Komisioni Evropian në një deklaratë të hënën.

Pakoja e re e sanksioneve shton 52 anije nga flota që përpiqet t'i shmangë kufizimet perëndimore për të transportuar naftë, armë dhe grurë. Kjo e çon numrin total të anijeve të listuara në 79.

BE-ja filloi të shtojë në listë këto anije më herët gjatë këtij viti si përgjigje ndaj një rritjeje të numrit të anijeve që



transportojnë ngarkesa të cilat nuk sigurohen nga ofruerit e zakonshëm perëndimorë. Lista përfshinte edhe anijet që dorëzuan municione koreano-veriore në Rusi.

Kufizimet e reja shtojnë 84

individë dhe entitete të reja, përfshirë shtatë persona dhe entitete kineze, si dhe entitete ruse në Serbi. "Një individ dhe dy entitete që lehtësojnë shmangien e sanksioneve të BE-së, dhe katër entitete që

furnizojnë komponentë të ndjeshëm për dronë dhe komponentë mikroelektronikë për ushtrinë ruse", thuhet në deklaratë, në pjesën ku iu referohet entiteteve kineze.

Kjo do të jetë hera e parë që entitete kineze përballen me sanksione të tilla për ndalimin e udhëtimeve dhe ngrirjen e aseteve. "Hapi drejt sanksioneve të mirëfillta jep një sinjal të rëndësishëm për kinezët. Ne e marrim këtë shumë seriozisht", tha një diplomat i BE-së.

Shefi i sanksioneve të BE-së, David O'Sullivan, dhe zyrtarë ukrainas kanë fajësuar Kinën për shitjen e teknologjisë së huaj në Rusi.

Diplomatët thanë se listimet e mëparshme kineze në pakon e sanksioneve ruse përfshinin vetëm kontrollin e eksporteve, në vend të një sanksioni të përgjithshëm.

Lista tani përfshin drejtues të lartë në sektorin energjetik të Ruisë, dy zyrtarë të lartë koreano-veriorë, si dhe 20 kompani dhe entitete ruse në Indi, Iran, Serbi dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Komisioni po përgatit një pako të 16 sanksioneve për janar, e cila mund të përfshijë masa më të gjera si ndaj gazit natyror të lëngshëm rus dhe kufizime të eksporteve për filialet e kompanive të BE-së në vendet e treta, thanë burime për "Reuters".

BE-ja dërgon një diplomat për të biseduar me udhëheqësit e rinj të Sirisë

BRUKSEL, 16 DHJETOR - Shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, tha të hënën se i dërguari i bllokut për Sirinë do të shkojë në Damask për të biseduar me udhëheqësit e rinj të Sirisë, ndërsa fuqitë perëndimore po shtojnë angazhimet pas rrëzimit të Bashar al-Asadit.

Kjo lëvizje nga Brukseli vjen pasi Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe thanë se kishin kontaktuar autoritetet e reja në Damask, të udhëhequra nga grupi rebel Hayat Tahrir al-Sham (HTS).

Fuqi rajonale dhe ndërkombëtare kanë nisur kontaktet me liderët e rinj në Siri pas rrëzimit të Asadit përmes një ofensivë, duke u

dhënë fund pesë dekadave të sundimit të familjes së tij. "Diplomati ynë kryesor për Sirinë do të shkojë sot në Damask. Do t'i kryejmë kontaktet atje", u tha Kallas gazetarëve para një takimi të ministrave të Jashtëm të BE-së. Vendet e BE-së - si vende të tjera në Perëndim - janë treguar të kujdesshme në deklaratat ndaj udhëheqjes së re në Damask, duke pasur parasysh që HTS-ja kishte rrënjë në Al-Kaeda dhe është e listuar si një grup terrorist nga një numër qeverish.

BE-ja ndërpreu lidhjet me regjimin e Asadit në Damask gjatë luftës civile të vendit, por ka vazhduar të dërgojë ndihma humanitare për t'i ndihmuar



popullatat lokale. Kallas tha se ministrat e Jashtëm të BE-së në Bruksel do të diskutojnë "se si të angazhohemi me udhëheqjen e re të Sirisë dhe në çfarë niveli të

angazhohemi". "Nuk mund ta lëmë një vakum", tha Kallas, e cila mori detyrën diplomate kryesore e BE-së këtë muaj. Aktorët ndërkombëtarë kanë shprehur optimizëm të

kujdesshëm pasi autoritetet e reja në Damask janë zotuar t'i mbrojnë pakicat dhe të formojnë një qeveri gjithëpërfshirëse.

Diplomatët thonë se disa shtete anëtare të BE-së po shtojnë për t'i rritur lidhjet me Sirinë pas rrëzimit të Asadit, ndërsa të tjerët janë më skeptikë. "Për ne nuk janë vetëm fjalët, por duam të shohim veprime që shkojnë në drejtimin e duhur. Pra, jo vetëm çfarë po thonë, por edhe çfarë po bëjnë", tha Kallas.

"Mendoj se javët dhe muajt e ardhshëm do të tregojnë nëse gjërat do të shkojnë në drejtimin e duhur. Dhe mendoj se atëherë do të jemi të hapur për të diskutuar për hapat e ardhshëm", shtoi ajo.

GRENELLI PRAPA PORTËS



**Behxhet
Sh. SHALA-BAJGORA**

Nuk është Grenell si Hanibali: Hanibali, i biri i Hamilkarit ishte një udhëheqës e strateg ushtarak kartagjenas që i shkaktoi shumë probleme perandorisë Romake sa që nënat romake, për t'i frikësuar fëmijët i kërcënonin me fjalët: "Hanibal ante portas - Hanibali është para derës...". Në një betejë kundër legjioneve romake, Hanibali me 50,000 ushtarë, 39 elefantë dhe 9000 kalorës rrethoi 80,000 legjionarë romakë dhe i vrau thuaja të gjithë. Betejën vendimtare e humbi nga Shqipëri. Richard Grenell gjatë mandatit Tramp 1 kishte

Për të mos rënë i gjallë në duar romakëve, Hanibali bëri vetëvrasje. Veprimi i ushtar dhe gjeneral me dinjitet. Richard Grenell gjatë mandatit Tramp 1 kishte

shumë pozita me rëndësi sikur që mbante pozitën kyçe të koordinatorit të Sigurisë Kombëtare amerikane ku ishin, së paku 16 institucionet kryesore për zbulim dhe kundërzbulim të ShBA-ve. Kush zotëron informatën është mbret i botës kurse Grenell zotëronte të gjitha informatat. Mbahet mend që, së bashku me opozitën në kohën e pandemisë me Covid-19 e rrëzoi qeverinë Kurti 1 duke e shndërruar në martir, pak nën Jezu Krishtin. Kjo, midis tjerash ndikoi që në zgjedhjet e radhës, Albin Kurti me matrushkën Vojsa Osmani dhe analfabetin politike, Donika Shvarc fitoi 51 për qind të votave. Zgjedhjet e radhës i fitoi Sleeping Joe dhe Trampi doli jashtë loje, bashkë me Grenellin që iu kushtua turizmit biznesor në Serbi dhe Shqipëri. Tërë kohën lloboi dhe i mbeti besnik presidentit Tramp i cili përndiqej nga një vrasës juridik, prokurori Jack Smith, në mos për ta futur në burg, së paku për ta penguar të garojë në zgjedhjet presidenciale në ShBA. Nuk ia arriti as të parën e as të dytën, Trampi u zgjodh president me pjesën dërrmuese të votave elektorale dhe popullore duke siguruar fitoren republikanëve shumicën edhe në Kongres si dhe në

Senat. Tash, nuk flitej nëse Grenell do të jetë pjesë e kabinetit Tramp 2 por se, do të zgjedhë postin sikur që njohësi i mirë zgjedhë shalqinin. Nuk doli të jetë ashtu dhe, për mendimin tim Grenell është degraduar në Administratën Tramp 2 krahasuar me pozitën gjatë Tramp 1. Së fundi, sipas mediave, Grenell është caktuar si emisar special për zgjidhje të vatrave të krizës kudo në botë (post shumë i përgjithësuar), me theks të veçantë në Kore të Veriut, Venezuelë dhe Ballkan. Përkthyer në situatën aktuale i bie të punojë me Nikolas Maduron e Venezuelës apo LV-në e Venezuelës, Kim Jong Unin e Koresë së Veriut, LV-së së këtij shteti komunist dhe diktatorial, Aleksandrar Vuçiqin e Serbisë dhe Albin Kurtin, kryetar i LV-së dhe KM i Kosovës, nëse mbetet në pushtet pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025. E përbashkëta e këtyre katër shteteve është se kanë udhëheqës të majtë, janë diktatorë (Maduro, Kim Uni dhe Vuçiqi kurse Kurti seriozisht po përpigjet të bëhet diktator përmes autoritarizmit institucional dhe partiak duke dhunuar opozitën, mediat, pjesën e panënshtuar të shoqërisë civile, gjykatat dhe prokurorinë). Maduro dhe Kimi janë komunistë ortodoks, Vuçiqi

është një nacionalsocialist me të kaluar komuniste ndërsa Kurti shitet si liberal por që jetën e ka të një aristokrati si i familjes borgjeze të Burbonëve. Venezuela dhe Koreja e Veriut nuk kanë marrëdhënie me Washingtonin, Vuçiqi i ka raportet e mira kurse, të tilla i deklaroi edhe Kurti përmes një rrenci dhe mashtuesi që quhet Besnik Gjylekari, duket të jetë stërnip i Hamilkarit, babait të Hanibalit. Ky është rebusi i katërshit me të cilën do të merret Richard Grenell gjatë mandatit të tij si "emisar special". Për vatrë kryesore, Ukraina, Tajvani, Irani, Gaza dhe tash edhe Siria, Tramp ka tjerë emisarë.

Grenell dhe Kosova: I kemi dy situata apo dy pole, pushteti nuk ndjehet mirë që Grenell po e shkelë përsëri Ballkanin, lexo Kosovën kurse opozita mendon se vota e Grenellit kundër Kurtit do ta sigurojë fitoren e saj. Po e shihni që pozita po tregohet e matur dhe reformuar për mandatin e Grenellit, nuk po e konsideron as si nuse e as si dhëndër të Gjakovës që le të nënkuptohet se Albin Kurti, nëse mbetet në pushtet megjithatë do "të shtrihet pranë Grenellit", krahasuar me mandatin e parë kur këtë privilegj dhe kënaqësi me atribut kryesisht seksuale e kishte rezervuar për LDK-në.

Besoj se shkëmbimi i territoreve nuk do të jetë pjesë e marrëveshjes me Serbinë përveç nëse sillemi si adoleshentë politikë dhe, "e sjellim ujkun në torishtë...". Çdo gjë që kalon overdozën, sjell pasoja edhe për jetën, pavarësisht shijes. Edhe overdoza e sovranitetit folklorik prodhon këto pasoja prandaj duhet më shumë mobilizim të pozitës dhe opozitës pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 e t'i shmangemi këtij kurthi që po menaxhohet nga Serbia.

Kosova askund nuk është ndër prioritetet sidomos kur bota po vlon nga rreziku i një lufte globale. Po të ishte Kosova një problem i izoluar, moti do të bëhej puna lesh, në rrethanat aktuale që e kemi Shqipërinë, gjendja në Bosnje, Maqedoni të Veriut, Serbi, Mal të Zi, Bullgari problemi i Kosovës mund të prodhojë efektin domino apo zinxhirizimin e konflikteve etnike, për ndryshime territoriale.

Opozita ka një milion argumente për ta sfiduar qeverinë Kurti 2 dhe për ta mundur bindshëm prandaj nuk duhet ta përdorin Grenellin si votues përcaktues për fitoren e tyre sepse nuk iu del ashtu. Trampi 2 nuk është si Trampi 1 e as Grenelli 2 nuk do të jetë si Grenelli 1. Mbajeni në mend dhe kujdes, për të gjithë!

Mospajtime të mëdha në BE rreth heqjes së masave ndaj Kosovës

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Këshilli i Bashkimit Evropian do të mund të deklarojë javën që vjen se do t'i heqë gradualisht masat ndëshkuese ndaj Kosovës, por paralelisht me hapat e tjerë që duhet të ndërmarrë Kosova për t'i ulur tensionet në veri. Kjo porosi do të duhej të ishte pjesë edhe e konkluzioneve të ministrave të vendeve anëtare, që do të takohen të martën, më 17 dhjetor, në Bruksel, në të ashtuquajturin Këshill i Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian. Por, edhe në këtë pikë ka dallime në qëndrime mes vendeve anëtare, prandaj për këto konkluzione do të ketë sërish diskutime të dielën mes ambasadorëve të vendeve anëtare.

"Radio Evropa e Lirë" ka pasur qasje në draftin e këtyre konkluzioneve ku përmenden edhe çështje të tjera lidhur me procesin e zgjerimit të BE-së. "Në përputhje me deklaratën e Përfaqësuesit të Lartë, në emër të BE-së, BE-ja i ka zbatuar masat ndaj Kosovës. Këshilli do t'i heqë gradualisht këto masa, paralelisht me hapat e tjerë të Kosovës për shtensionim në



veri. Këshilli do të merret me këtë çështje", thuhet në versionin e fundit të draftit të konkluzioneve që do të duhej të miratoheshin të martën në takimimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme. Versioni i mëhershëm nuk përmendi fare heqjen e

masave dhe ishte pothuajse i njëjtë sikurse ai i vitit të kaluar, duke injoruar faktin se përfaqësuesi i lartë kishte dhënë ndërkohë rekomandime që masat të hiqeshin. Përderisa versioni i mëhershëm i draftit të

konkluzioneve dukej "shumë negativ" sa iu përket masave ndaj Kosovës, versioni i ri disa vendeve u duket "tepër pozitiv". Prandaj është e paqartë se si do t'iu referohen vendet anëtare këtyre konkluzioneve.

Në disa takime të ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së janë shfaqur dallime sa iu përket masave ndaj Kosovës. Shumica e vendeve anëtare kanë kërkuar që ato të hiqen menjëherë dhe në tërësi. Por disa vende të tjera, të udhëhequra nga Franca dhe Italia, duan që masat të hiqen gradualisht.

Vazhdimi i mospajtimeve rreth mënyrës së heqjes së masave ndaj Kosovës ka bërë që ato të mos hiqen fare. Sipas burimeve diplomatike të "Radios Evropa e Lirë" brenda BE-së, ato mund të mos hiqen para zgjedhjeve në Kosovë që janë caktuar për 9 shkurt të vitit që vjen.

Blloku evropian pati vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023, pas rritjes së tensioneve në veri të vendit. BE-ja pati vlerësuar se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë mjaftueshëm për shtensionim.

Dy palët më pas janë pajtuar për marrjen e disa masave ndaj Kosovës në këmbim të heqjes së masave. Autoritetet e Kosovës deklarojnë se i kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe masat e BE-së i konsiderojnë të padrejta.



Kurti s'paraqitet në Prokurorinë Speciale për rastin e rezervave shtetërore

Kryeministri Albin Kurti ishte ftuar të hënën nga Prokuroria Speciale e Kosovës, që të intervistohet në cilësinë e dëshmitarit lidhur me një çështje penale që po hetohet nga kjo prokurori. Kurti, për shkak të angazhimeve zyrtare jashtë vendit, nuk ishte i pranishëm në Prokurorinë Speciale. Megjithatë, kryeministri ka shprehur gatishmërinë t'i presë prokurorët e rastit në zyrën e tij. Ndërkaq opozita e ka kritikuar kryeministrin Kurti për qasjen e tij karshi gjyqësorit dhe prokurorisë

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk është paraqitur të hënën në Prokurorinë Speciale, edhe pse i është bërë ftesë qysh javën e kaluar për të dëshmuar sot në orën 9:30 lidhur me rastin e rezervave shtetërore. Zëdhënësja e Prokurorisë Speciale, Liridona Kozmaqi, tha se zyra e kryeministrit ka njoftuar se Kurti nuk mund të paraqitet për të dëshmuar pasi që është në udhëtim jashtë vendit. Një ditë më herët Kurti kishte publikuar në rrjete sociale fotografi nga vizita e tij në Slloveni. Kozmaqi tha se Prokuroria Speciale do ta ftojë Kurtin për të dëshmuar në një datë tjetër. Por, zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, i tha REL-it se Kurti "ka shprehur gatishmërinë t'i

mirëpresë prokurorët e rastit në zyrën e tij në një ditë dhe orë të dakorduar nga të dyja palët për ta përmbushur kërkesën e dalë nga ftesa e prokurorisë". Për drejtorin e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, kjo qasje "është tallje me Prokurorinë Speciale dhe sistemin e drejtësisë". "Ky qëndrim nuk duhet parë ndryshe, vetëm si injorim i obligimeve të tij kushtetuese dhe ligjore dhe mesazhi më i keq që dërgohet te publiku lidhur me vullnetin e tyre për luftimin e korrupsionit", thotë Miftaraj për "Radion Evropë e Lirë". Ai shpreson se Prokuroria Speciale do të vazhdojë t'i ndjekë procedurat e rregullta dhe do ta caktojë një datë të re "sa më shpejt" në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i hetimeve.

"Varësisht kur është marrë aktvendim për fillimin e hetimeve në këtë rast, prokurori i Shtetit i ka afat dy vjet për të marrë vendim qoftë për të ngritur aktakuzë ose jo", tha Miftaraj. "Duke marrë parasysh që për këtë rast ka pasur arrestime në muajin gusht të vitit 2023, ka mundësi që aktvendimi është marrë edhe pak para kësaj kohe, kështu që prokurori do të duhej ta bënte planifikimin e duhur për t'u siguruar që ky rast të trajtohet në mënyrë efikase", shtoi ai. Katër ditë më parë burime të "Radios Evropë e Lirë" në Prokurorinë Speciale e kishin konfirmuar se Kurti është ftuar lidhur me rastin e rezervave shtetërore, në të cilin është e implikuar edhe ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Rozeta

Hajdari. Në gusht të vitit të kaluar disa persona ishin arrestuar për keqpërdorime të rezervave shtetërore. Në mesin e të arrestuarve kishte edhe punonjës të MINT-it. Bastisjet dhe arrestimet u bënë pas publikimit të disa audioincizimeve nga portali "Nacionale" në Kosovë, në të cilat pretendohet se vaji i kontraktuar dhe i paguar në Poloni për rezervat shtetërore të Kosovës, si dhe rezervat e grurit, nuk kishin arritur kurrë. Hajdari kishte thënë në atë kohë se blerjet për rezerva shtetërore janë bërë në përputhje me ligjin, por nuk kishte dhënë më shumë hollësi. Kurti i kishte dalë në mbrojtje Hajdarit, duke thënë se "nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi". Pas ftesës për intervistim në Prokurorinë Speciale, nën dyshimet se ka keqpërdorur detyrën zyrtare në lidhje me rezervat shtetërore, Hajdari ishte mbrojtur në heshtje në paraqitjen e saj para prokurorëve. Rezervat shtetërore përbëhen nga mielli, vaji, sheqeri, barnat, produktet higjienike, nafta etj., që mund të përdoren

në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme - si pasojë e fatkeqësive natyrore apo luftërave - por edhe në rast të mungesës së këtyre artikujve në treg.

Ato i menaxhon Departamenti i Rezervave Shtetërore të Mallrave, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kosova nisi mbledhjen e këtyre rezervave nga viti 2012. Ato sigurohen me buxhet të shtetit, por edhe nga mallrat në konfiskohen për shkak të veprave kundërvajtëse dhe kalojnë në pronësi të shtetit. Se sa është sasia e këtyre rezervave nuk dihet, meqë ky informacion, me Ligjin për Rezervat Shtetërore, konsiderohet sekret shtetëror, ashtu si edhe vendndodhja e tyre.

Opozita: Kurti po dërgon sinjale të gabuara për sundimin e ligjit

Opozita e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti për qasjen e tij karshi gjyqësorit dhe prokurorisë. Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK),

Kuvendet e dy shteteve Kosovë - Shqipëri mblidhen më 20 dhjetor

Prishtinë, 16 dhjetor - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e prirë nga kryetari Glauk Konjufca, mbajti të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën u diskutua për organizimin e një

mbledhjeje të përbashkët me deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë mbledhje, në të cilën morën pjesë edhe kryetarët e grupeve parlamentare, u vendos që më 20 dhjetor, me fillim nga

ora 11:00, deputetët e të dyja kuvendeve të mblidhen në një mbledhje të përbashkët. Lidhur me agjendën e mbledhjes, në kryesi u vendos që me një fjalë rasti të pranishmëve t'u

drejtohen kryetarët e kuvendeve përkatëse, kryeministrat, si dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Kryesia me këtë rast shqyrtoi edhe disa propozime dhe kërkesa.



FSK-ja mban ligjërata të me nxënës për rrezikun nga mjetet piroteknike

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Në kuadër të aktiviteteve vjetore, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, është duke mbajtur ligjërata për "Rrezikun nga mjetet piroteknike" me nxënës të

shkollave të mesme të ulëta në Republikën e Kosovës. Ekipet trajnuese të çminimit të FSK-së kanë për qëllim vetëdijësimin e nxënësve për rrezikun që mund të shkaktojnë mjetet piroteknike gjatë përdorimit të tyre, veçanërisht tani që jemi në prag të festave të

fundvitit. Forca e Sigurisë së Kosovës është e përkushtuar për ngritjen e nivelit të sigurisë në të gjitha fushat, me këtë rast kërkon bashkëpunim me prindërit për zvogëlim të incidenteve që mund të shkaktohen gjatë përdorimit të këtyre mjeteve.



Vitia nënshkruan përditësimin e fundit të listës esenciale të produkteve mjekësore



PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka nënshkruar përditësimin e fundit të listës esenciale të produkteve mjekësore dhe materialit shpenzues. "U shtuan 7 produkte të reja bashkëkohore për trajtimin e kancerit të gjirit dhe melanomës, kancerit agresiv të lëkurës. U shtua materiali shpenzues për shërbimin e ri Stroke, i cili shpëton jetën e

pacientëve që përjetojnë sulm në tru dhe dëmtime të enëve të gjakut në tru. Këto arritje u mundësuan falë buxhetit prej 70 milionë eurosh për barnat esenciale. Buxheti më i madh ndonjëherë. Ky është përditësimi i nëntë brenda 19 muajve. Në vitin 2025 do të vazhdojmë ta përditësojmë më tej listën me produkte të reja për qytetarët tanë", ka shkruar Vitia në "Facebook".

Inaugurohet Zyra Regjionale e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e BE-së, Aivo Orav, me të cilin ka diskutuar për mbështetjen e BE-së dhënë Ministrisë së Bujqësisë dhe sektorit agro-ushqimor të Kosovës. Gjithashtu, ata inauguruan edhe zyrën qendrore në Prishtinë dhe katër zyra rajonale, duke krijuar një

rrjet prej pesë zyrash moderne për monitorimin e operatorëve ekonomikë, inspektimet veterinarë dhe zbatimin e sigurisë ushqimore. "BE-ja ka vlerësuar se progresi më i madh në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë është arritur këtë vit që nga paslufta. Po ashtu, jemi në procedurë për ndërtimin e objektit të ri të ministrisë, me

vlerë 9 milionë euro, i cili do të mundësojë plotësimin e kriterëve të IPARD-it si dhe qasjen në 150 milionë euro për bujqësi në vit nga fondet e Bashkimit Evropian. Kosova po bën përpertime të rëndësishme drejt standardeve të BE-së, duke garantuar produkte të sigurta dhe cilësore për të gjithë konsumatorët", ka theksuar ministri Peci.



Arben Gashi, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, ka deklaruar se sjellja e Kurtit përfaqëson një koncept të gabuar që dërgon mesazhe negative për qytetarët. "Ky është një model i gabuar i sjelljes së LV-së. Sjellja e supremacisë politike të

ekzekutivit mbi gjyqësorin dhe prokurorinë është e papranueshme", tha Gashi. Teksa foli edhe për ftesën që ua ka bërë prokurorëve për takim në zyrën e tij, Gashi tha se kjo është ende më keq. "Ende më keq që të thirret prokurori dhe sjellja e

ekzekutivit mbi prokurorinë është e gabuar dhe nënkupton vlerësimin e tij mbi gjyqësorin. Nëse vlerëson se duhet të kemi drejtësi, atëherë duhet t'u përgjigjet ftesave", tha ai para medieve. Edhe shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të

Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, e kritikoi përgjigjen e Kurtit ndaj Prokurorisë Speciale, duke e cilësuar mesazh të keq për qytetarët e Kosovës. "Është shembull i keq për mënyrën se si një lider i përgjigjet Prokurorisë", ka deklaruar Tahiri.

Ndërkaq, deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, theksoi se kryeministri Kurti duhet ta respektojë ligjin. "Kryeministri nuk është mbi ligjin", ka thënë Kadrijaj, duke i bërë thirrje për qasje më të përgjegjshme ndaj institucioneve të drejtësisë.

Kryetari i Rahovecit mban mbledhjen e radhës me drejtorët e drejtorive

RAHOVEC, 16 DHJETOR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur mbledhjen e përjavshme me drejtorët e

drejtorive, me të cilët ka diskutuar për ecurinë e punëve, sfidat në zbatimin e projekteve aktuale dhe

strategjitë për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve komunale. Në takim u theksua edhe rëndësia e koordinimit të

ngushtë ndërmjet drejtorive për ta rritur efikasitetin e punës dhe për t'i adresuar nevojat e qytetarëve.



Në Gjilan jepen dhurata dhe mjete higjienike për fëmijët me Sindromën Down

GJILAN, 16 DHJETOR - Komuna e Gjilanit së bashku me Asamblenë Komunale të Fëmijëve kanë vazhduar shpërndarjen e dhuratave në prag të festave të fundvitit. Deri tash kanë pranuar dhurata mbi 200 fëmijë. Udhëheqësi i sektorit për të drejtat e njeriut në komunën e Gjilanit, Ardian Foniqi, tha se së bashku me Asamblenë Komunale të Fëmijëve kanë realizuar me sukses një tjetër aktivitet humanitar, duke shpërndarë dhurata për fëmijët me Sindromën Down. "Këta fëmijë të

mrekullueshëm janë frymëzuar për të gjithë ne dhe ishte kënaqësi e veçantë ta ndanim gëzimin e festave me ta", tha Foniqi. Udhëheqësi i sektorit për të drejtat e njeriut në komunën e Gjilanit tregoi se, gjithashtu, për disa muaj me radhë kanë mbështetur Qendrën e Sindromës Down me furnizime të vazhdueshme të mjeteve higjienike, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve. "Ky aktivitet është shprehje e përkushtimit tonë për përfshirje, barazi dhe

dashuri ndaj çdo anëtarë të komunitetit. Le të vazhdojmë të punojmë së bashku për një shoqëri më të drejtë dhe më humane, ku çdo fëmijë të ndihet i përkrahur dhe i vlerësuar", tha Ardian Foniqi. Ndërkohë u realizua edhe një koncert për fëmijët, në të cilin kënduan Arian Agushi (Gold AG), Enkleda Arifi dhe fëmijët i gëzuan me zërat e tyre të bukur. "Gëzimi i tyre është frymëzuar për të vazhduar projektet që sjellin buzëqeshje në fytyrat e më të vegjëlvë", tha Foniqi.



Komuna e Fushë-Kosovës pranon 943 kontejnerë donacion nga USAID-i



FUSHË-KOSOVË, 16 DHJETOR - Në kuadër të bashkëpunimit efektiv, komuna e Fushë-Kosovës, në bashkëpunim me ECMI dhe Kompaninë Regjionale "Pastrimi", kanë shënuar aktivitetin kryesor të pranimit-dorëzimit të 470 kontejnerëve me kapacitet 1 100 litra dhe 473 kontejnerëve me kapacitet 240 litra të financuar nga USAID-i. "Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të projektit të bashkëpunimit që

ka në fokus krijimin e një modeli të qëndrueshëm të riciklimit të mbeturinave brenda territorit të komunës sonë, promovimin e kohezionit social si dhe ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave", ka njoftuar komuna e Fushë-Kosovës. Komuna në bashkëpunim me Kompaninë "Pastrimi" ka përgatitur hartën e shpërndarjes së tyre që nënkupton pikat e reja të

grumbullimit dhe shtimin e kapaciteteve në pikat ekzistuese dhe së bashku me këtë edhe aktivitetet promovuese e këshilluese për një menaxhim më cilësor të grumbullimit të mbeturinave. Ditët në vijim qytetarët përmes stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe të Kompanisë "Pastrimi" do të informohen me proceset e reja të nevojshme për klasifikimin e mbeturinave në burim.

Fillon vendosja e numrave të adresave në objektet publike dhe private në Podujevë



PODUJEVË, 16 DHJETOR - Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Liridon Gashi, kanë marrë pjesë në ceremoninë e fillimit të projektit për vendosjen e numrave të adresave në objektet publike dhe private në komunën e Podujevës.

Kryetari Bulliqi e quajti këtë hap të rëndësishëm për standardizimin e adresave dhe tha se ky do të jetë një lehtësim jo vetëm për qytetarët, por edhe për institucionet për të pasur adresa të sakta dhe planifikim më të mirë. Ky është projekt i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kurse financohet nga Banka Botërore. Me këtë projekt në vlerë prej 160 080 eurosh do të vendosen 32 016 numra në objekte publike e private në komunën e Podujevës dhe pritet të përfundojë deri më 30 janar 2025.

"Vrapo Babadimër" mbledh mbi 5 000 pjesëmarrës në Prishtinë

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Sheshet e Prishtinës u mbushën me babadimra të dielën të cilët morën pjesë në edicionin e 9-të të minimaratonës "Vrapo Babadimër". Rreth 5 000 persona morën pjesë në këtë aktivitet që kishte për qëllim mbledhjen e fondeve për fëmijët me nevojë dhe ata që trajtohen në

Klinikën e Hematoonkologjisë të QKUK-së. "Në shesh, babadimra të vegjël e të mëdhenj, me buzëqeshje e plot energji, vrapuan për një kauzë më të madhe se ne të gjithë. Vrapimi ynë sot nuk ishte thjesht një minimaratonë, por një akt solidariteti për ata që kanë më shumë nevojë. Çdo hap ishte një dhuratë për dikë tjetër, një

mësim për fëmijët tanë dhe një shembull i madh për qytetin tonë. Kjo iniciativë për 9 vjet radhazi po na mëson se fuqia e bashkimit mund ta ndryshojë botën. Kryeqyteti me këtë aktivitet tregoi se fryma që na duhet është këtu - buzëqeshja, bamirësia dhe zemra e madhe që rreh për të tjerët", ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.



Padia për gjenocid, Hetemi: Do t'i ofrojmë dëshmitë kurdo që na kërkohen

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Instituti për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë nuk ka mandat që të ndërmarrë iniciativa për ta ngritur padinë kundër Serbisë për gjenocid, por do të ofrojë dëshmitë që i ka, kurdo që institucionet ia kërkojnë. Kështu thotë në një intervistë për "KosovaPress", drejtori i këtij instituti, Atdhe Hetemi, sipas të cilit, për të arritur paqe të qëndrueshme në rajon, duhen hapa për vendosjen e drejtësisë.

Në institutin e formuar nga ekzekutivi në fund të 2023-s, tashmë nga komunat e

Kosovës dhe institucionet e ndryshme janë dorëzuar dokumente dhe materiale që dokumentojnë krimet e luftës. Hetemi thotë se deri tani kanë grumbulluar mbi 200 metra material arkivor dhe mijëra orë videoincizime dhe materiale që janë dëshmi e krimeve serbe në Kosovë. "Ne si institut nuk është që kemi mandat që të marrim iniciativa sa i përket padisë e kështu me radhë, mirëpo kurdo që institucionet e tjera që e kanë këtë mandat e marrin ndonjë iniciativë të tillë, Instituti është i obliguar



t'i ofrojë dëshmitë dhe dokumentet të cilat i ka në mënyrë që institucionet e tjera

ta bëjnë punën e tyre edhe në këtë drejtim. Përndryshe, instituti ka më tepër karakter

akademik. Është e domosdoshme që për t'u arritur një paqe e qëndrueshme në rajon, fillimisht të bëhet dokumenti i mirëfilltë, gjë të cilën jemi duke e bërë, pastaj të merren hapa për vënien e drejtësisë në vend, reparacionin e kështu me radhë, por këto i bëjnë institucionet e tjera", thotë ai. Kryeministri Albin Kurti kishte paralajmëruar se qeveria e tij do ta përgatisë padinë kundër Serbisë për gjenocid pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Diçka konkrete nuk është parë në këtë drejtim.

KFOR-i hedh poshtë raportimet se ua ndaloi zyrtarëve hyrjen në komunën e Leposaviqit

LEPOSAVIQ, 16 DHJETOR - Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, i ka hedhur poshtë raportimet e disa medieve lokale në Kosovë, kinse ky mision ka futur në listë të zezë disa zyrtarë të institucioneve të Kosovës dhe ua ka ndaluar hyrjen në objektin e komunës së Leposaviqit. "KFOR-i nuk ndërhyr në lirinë e lëvizjes së individëve në Kosovë. KFOR-i mban kontakte të rregullta me të gjitha palët kryesore". Misioni u ka bërë thirrje të gjitha palëve që të përmbahen nga deklaratat dhe veprimet e njëanshme që mund të krijojnë tensione të panevojshme dhe mund të ndikojnë në stabilitetin rajonal. KFOR-i ka mbi 4 400 trupa

ushtarake në Kosovë dhe është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX.

Raportime të ngjashme për, kinse, ndalesë të vendosur nga KFOR-i për hyrjen e zyrtarëve të Kosovës në institucione të veri të vendit - të banuar me shumicë serbe - ka pasur disa herë brenda vitit.

Më herët gjatë javës, ambasadori amerikan në Shkup, Jeffrey Hovenier ka thënë se aktorë të huaj keqdashës synojnë ta minojnë demokracinë e Kosovës duke shfrytëzuar ndasitë etnike. Edhe Ramadan Ilazi, drejtor i



hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i ka thënë Radios Evropa e Lirë këtë javë se fushatat dezinformuese shpërndahen qëllimshëm në

Kosovë për t'i tensionuar marrëdhëniet ndëretnike. "Kemi fushata që kanë për qëllim të krijojnë mosbesim - sidomos në mesin e komunitetit serb - ndaj

institucioneve publike në Kosovë dhe që synojnë të krijojnë një lloj perceptimi sikur në veri [të Kosovës] e kemi një situatë represioni të vazhdueshëm ndaj qytetarëve atje".

Më herët gjatë javës në Prishtinë është mbajtur një konferencë për integritetin e informacionit DISICON, të organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) me seli në Uashington. Mes të tjerash, në të është thënë se dezinformatat mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri, sidomos në kohë zgjedhjesh.

Kosova do t'i mbajë zgjedhjet e ardhshme parlamentare më 9 shkurt të vitit tjetër.

Pleurat Sejdiu rikthehet në politikë, garon për deputet me listën e PDK-së



PRISHTINË, 16 DHJETOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dorëzuar listën e 110 kandidatëve për deputetë në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025.

Kjo listë, e cila nga PDK-ja është quajtur listë e ekipit fitues, përfshin personalitete të rëndësishme që në kohë të ndryshme kanë dhënë kontribut për vendin. Në mesin e këtyre personaliteteve është edhe Pleurat Sejdiu, një nga mjekët më të mirë në vend dhe veprimtar i dalluar.

Pas një pauze të gjatë nga jeta

politike, ai në këto zgjedhje ka vendosur të jetë pjesë e garës për deputet dhe mban numrin 53 në listën e PDK-së, shkruan "Epoka e re".

Pleurat Sejdiu është një nga themeluesit e PDK-së si dhe pos punës në profesionin kirurg ortoped brenda dhe jashtë vendit, ka mbartur shumë funksione të rëndësishme në skenën publike si: përfaqësues diplomatik i UÇK-së - Shtabi i Përgjithshëm, Drejtorja Politike / Ushtria Çlirimtare e Kosovës; zëvendësministër i Punëve të Jashtme, Qeveria e Përkohshme e Kosovës;

bashkëdrejtues i Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative (UNMIK); sekretar në Ministrinë e Shëndetësisë; drejtor - Drejtorja për Trajnime, Komunikim dhe Informim, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Integrim Evropian; drejtor - Departamenti për Strategji dhe Koordinim, Ministria e Integritimit Evropian; kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës. Rikthimi i Pleurat Sejdiut pritet të sjellë një përvojë të re në skenën politike.

Edita Tahiri: Ta heqim këtë qeveri, në zgjedhjet e 9 shkurtit i heqim sanksionet e BE-së

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Editra Tahiri ka thënë se Bashkimi Evropian nuk do t'ia heqë ndëshkimin Kosovës duke qenë se kjo çështje nuk përmendet në draft-

konkluzionet e Këshillit të Ministrave të BE-së.

Ajo ka shkruar në "Facebook" se gjasat janë ta heqim këtë qeveri në zgjedhjet e 9 shkurtit në mënyrë t'i heqim

sanksionet. "Bashkimi Evropian nuk do t'ia heqë ndëshkimin Kosovës duke qenë se kjo çështje nuk përmendet në draft konkluzionet e Këshillit të

Ministrave të BE-së - gjasat tona janë ta heqim këtë qeveri në zgjedhjet e 9 shkurtit që t'i heqim sanksionet", ka shkruar Tahiri.





Në Shoqatën 'Korabi' në Bolonjë të Italisë, një përvojë mbresëlënëse me praninë e presidentit të Shqipërisë Bajram Begaj



Prof. Dr. Kudusi LAMA, gjeneral në pension

Më 3 dhe 4 dhjetor 2024 isha i pranishëm si i ftuar në Shoqatën "Korabi" në Bolonjë të Italisë, prej ku, me praninë e presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Bajram Begaj, u bëra pjesë e një pamjeje të figurës së krenarisë kombëtare, që po na e ndërtojnë shqiptarët në vendet ku kanë shkuar si emigrantë edhe pa bukë me vete.

Ishte kjo veprimtari një përvojë mbresëlënëse e cila edhe me praninë e presidentit Begaj krijoi një mjedis shumë dinamik shqiptar, për të cilin nuk ishim krenarë vetëm ne shqiptarët, por edhe italianët. Presidenti ishte në qytet me ftesë të Shoqatës "Korabi", e themeluar në vitin 2022, për t'i promovuar marrëdhëniet miqësore, shkëmbimet kulturore, shkencore dhe sociale midis republikës italiane dhe republikës së Shqipërisë.

E në këtë vizitë presidentit Begaj iu bënë pritje të ngrohta përveç në Shoqatën "Korabi" dhe në kompaninë e biznesit "Poti", edhe në bashkinë e qytetit ku pati takim me kryetarin e bashkisë së Bolonjës.

Gjatë kësaj vizite iu kushtua rëndësi e veçantë lidhjes që është krijuar mes qytetit të Bolonjës dhe komunitetit shqiptar aktiv në të si nga pikëpamja institucionale, ashtu edhe nga ajo e marrëdhënieve shoqërore dhe

kulturore.

Në atë veprimtari të Shoqatës "Korabi" na u dha një pamje e plotë se cila ishte rruga e asaj shoqate dhe sipërmarrjet e saj, që e kishin bërë atë të nderuar si për komunitetin shqiptar në Itali, për komunitetin arbëresh, ashtu edhe për komunitetin italian e të tjerë. Në mes shqiptarësh dhe arbëreshëve, në prani të drejtuesve të rajonit Emilia-Romagnia, presidenti i Republikës, Bajram Begaj, bëri thirrje për të shfrytëzuar çdo mundësi me synim forcimin e lidhjeve dhe për të ndërtuar ura të reja bashkëpunimi në mes të Shqipërisë dhe Italisë. "Incontrarsi" quhej aktiviteti ku presidenti i Republikës ishte i ftuar nderi: "Faleminderit për këtë ftesë të ngrohtë dhe mundësinë për të qenë sot mes jush në këtë aktivitet kuptimplotë. 'Incontrarsi' ka domethënie mjaft të madhe. Për ne shqiptarët çdo takim është një mundësi e re, është një mundësi për të krijuar lidhje

për të forcuar ato që kemi, për të ndërtuar ura bashkëpunimi", tha ai në këtë veprimtari.

Duke shprehur mirënjohje ndaj autoriteteve më të larta të këtij qyteti dhe të rajonit Emilia-Romagnia për mbështetjen në bashkëpunimin e mëtijshëm Shqipëri - Itali. Presidenti Begaj një falënderim të posaçëm i drejtoi Shoqatës "Korabi" dhe presidentit të saj, afaristit të suksesshëm Astrit Poti, që ishte udhëheqësi i këtyre veprimtarive me ftesën e të cilit mori pjesë edhe presidenti. Në këtë falënderim presidenti Begaj u shpreh: "Jo vetëm që Korabi është mali më i lartë në Shqipëri, por është vendi ku rrinë shqiptonjat. Shqiptonja jeton gjatë. Ajo që është e rëndësishme për shqiptonjat është fakti se, duke qëndruar lart, shikojnë larg dhe qartë".

E në deklarimin e tij zyrtar, presidenti Begaj shkruan: "I nderuar të isha i ftuari i nderit i Shoqatës shqiptare 'Korabi'

që, nën moton 'Le të takohemi', mbledhi 320 biznese e profesionistë shqiptarë e arbëreshë që veprojnë në Itali. Si presidenti i Republikës së Shqipërisë mbështes çdo nismë që forcon lidhjet midis arbëreshëve dhe shqiptarëve të sotëm, që ruan identitetin tonë dhe kontribuon për të ardhmen e përbashkët të Shqipërisë dhe Italisë".

Një nga të veçantat e kësaj vizite ishte edhe pritja nga fëmijë e prindër të shkollës shqipe të hapur në Bolonjë, një investim i Shoqatës "Korabi" në këtë rajon, për të ruajtur e trashëguar gjuhën amtare.

Shumë kënaqësi e krenari për punën, arritjet dhe sukseset e shqiptarëve në Itali duke ruajtur gjuhën dhe traditat. Kjo shkollë e bën Shoqatën "Korabi" dhe presidentin e saj Astrit Poli një shembull se si duhet punuar e vepruar jo vetëm në Itali, por në të gjitha hapësirat evropiane e botërore.

Në këto veprimtari pati edhe një konferencë me pjesëmarrje masive të autoriteteve italiane të rajonit dhe ato shqiptare, ku u thanë fjalë shumë vlerësuese për Shoqatën "Korabi". Ashtu sikurse u zhvillua në vijim edhe një panel me studiues e funksionarë shqiptarë dhe italianë, të cilët shfaqën mendimet e tyre për punën e bërë dhe çfarë ishte e pritshme për zgjerimin e hapësirave të veprimtarisë, në interes të shqiptarëve dhe të italianëve e komuniteteve të tjera, dhe si e sa ka ndikuar Shoqata "Korabi", në gjallërimin e jetës dhe përmirësimin e kushteve për qytetarët e të gjitha komuniteteve në këtë rajon. Shoqata "Korabi" realisht ka marrë përgjegjësi për ta rritur autoritetin e shqiptarëve në Itali dhe më gjerë. Ajo përveç që ka themeluar shkollën shqipe për fëmijë dhe të rinj, ka marrë përgjegjësi edhe për t'i përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëve në këto hapësira. Një tregues është edhe rruga e ndërtuar nga kjo shoqatë me burimet e saj financiare. Rrugë e vila kuptohet në mënyrë simbolike të çon drejt një modeli të virtytshëm integrimi, me mbështetjen e kardinalit Zuppi, të presidentit të rajonit Stefano Bonaccini, të Don Massimo Vacchetti, të zëvendësministrit të Infrastruktura Galeazzo Bignami, këshilltarja për punët publike, Simone Borsari dhe kryetarja e distriktit Borgo Panigale-Reno, Elena Gaggioli. Pamjet e kësaj rruge dhe të përmirimit të saj, janë tregues i qartë se si shqiptarët arrijnë të jenë të integruar e shumë vital edhe kur nuk janë në vendin e tyre të origjinës.

Kjo rrugë në përmirimin e saj, bëri bashkë në një ceremoni festive komunitetin shqiptar në këtë rajon, atë arbëresh, së bashku me autoritetet





vendase, kur në kuadër të veprimtarive të 110 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar, morën pjesë edhe anëtarë të kabinetit qeveritar italian, përfaqësues të lartë të Vatikanit, drejtuesit më të lartë lokalë dhe qytetarë të shumtë. Në këtë ditë të shënuar, u inaugurua rruga që lidh aksin kryesor me "Villa Pallavicini", qendër humanitare në pronësi të Fondacionit "Gesù Divino Operaio", drejtuar nga Don Massimo Vacchetti dhe Armando Stafa. Ky investim u krye nga komuniteti shqiptar në Bolonjë, i përfaqësuar nga shoqata shqiptaro-arbëreshe "Korabi". Investimi i rëndësishëm, si në vlerë materiale, por mbi të gjitha me vlerën simbolike të çmuar, vjen si shenjë mirënjohjeje e shqiptarëve që jetojnë në këtë kryeqendër të vendit fqinj, ndaj kontributit të hershëm dhe të vazhdueshëm që dha kisha katolike e Bolonjës për shqiptarët që zbarkuan në jugun e Italisë, pas rënies së murit të diktaturës. Tek Villa Pallavicini, gjejmë mbështetje mijëra persona në nevojë, mes tyre dhe shumë shqiptarë. Rruga e rikonstruktuar falë investimit të shoqatës "Korabi", ka të vizatuar në të, shqiponjën dykrenare, portretet e figurave emblemë të shqiptarëve si Skënderbeu dhe Nënë Tereza, apo edhe të Kardinalit shqiptar, Ernest Troshani, pamjen e anijes "Vlora", si memorial i vuajtjes së shqiptarëve, por edhe i mikpritjes së fqinjëve në anën

tjetër të Adriatikut. Presidenti i shoqatës "Korabi", Astrit Poti, në emër të komunitetit shqiptar të pas '90-ës dhe atij arbëresh, ka vlerësuar rëndësinë e marrëdhënieve italo-shqiptare dhe mikpritjen që u është bërë emigrantëve në këto tri dekada, ndërsa zyrtarët italianë kanë vlerësuar integrimin e shqiptarëve në thujse çdo nivel përfaqësimi. Këtë ide e përqaftuan përnjëherësh biznesmenët pjesëtarë të bashkuar në shoqatën shqiptaro-arbëreshe "Korabi", e cila udhëhiqet nga sipërmarrësi i suksesshëm Astrit Poti. Ata mblodhën fondet, një shumë jo e vogël, dhe bënë atë investim të bukur, të rëndësishëm e simbolik, që mbetet shprehje e lidhjes midis dy vendeve e dy popujve tanë. Astriti me vëllain e tij, Osmanin, kanë një zinxhir ndërmarresh në

aktivitetin e tyre jo vetëm në Itali, por edhe jashtë saj. Me ta u bashkuan tre djemtë e 051, që është një zinxhir prej 13 restorantesh në pronësi të tyre, Ergisi, Bledari e Albi. Gjithashtu u bashkuan arbëreshi Luigji Lafusa me një koleg tjetër arbëresh, dy vëllezërit shkodranë aq simpatikë e të sjellshëm Ervin e Genc Podgorica, që kanë firma transporti dhe metalmekanike, kushërinjtë Lavdi e Julian Seferi që kanë gjithashtu aktivitetet e tyre e të tjerë. Shoqata "Korabi" përveç veprimtarive në Itali, shihet të veprojë edhe në Shqipëri, duke dhuruar për repartet e maternitetit të spitaleve të Kukësit dhe Vlorës dy inkubatorë të gjeneratës së fundit. Pajisjet e çmuara që shpëtojnë jetë u dorëzuan në dy iniciativa të veçanta nga

Presidenti i shoqatës, Astrit Poti dhe anëtarët e Korabit, në duart e mjekëve dhe të personelit mjekësor të dy spitaleve në datat 6 dhe 7 shtator 2024, në Spitalet e Kukësit dhe të Vlorës. "Shoqata jonë", do të thoshte Presidenti Poti, me këtë rast, "përbëhet nga sipërmarrës të afirmuar shqiptarë që jetojnë në Itali prej 30 vitesh dhe nga profesionistë të shquar me origjinë arbëreshe, të cilët kanë vendosur të bashkohen për të vepruar së bashku me vullnetin për të ndjekur qëllime qytetare, solidare, kulturore dhe sociale. Për më tepër, si grup shoqatash, ne promovojmë dhe mbështesim krijimin e një rrjeti marrëdhëniesh miqësie dhe shkëmbimesh kulturore, shkencore dhe sociale midis Italisë dhe Shqipërisë, me qëllim zhvillimin dhe forcimin e miqësisë dhe bashkëpunimit midis dy popujve". Ndër aktivitetet statutore të shoqatës "Korabi", qëllimi kryesor është ai i solidaritetit: anëtarët i kushtojnë në fakt vëmendje të veçantë bamirësisë dhe nismave të ndihmës për njerëzit në nevojë, si dhe mbështetje për nevojat e kujdesit të qytetarëve shqiptarë që banojnë në Itali ose që duhet të udhëtojnë në Itali për nevoja të kujdesit që nuk është e mundur të plotësohen në Shqipëri, me vëmendje të veçantë ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve. Komuniteti i sipërmarrësve shqiptarë në Bolonjë të Italisë, me anë të shoqatës "Korabi",

dha një kontribut me vlerë të lartë materiale dhe simbolike, në shërbim të bashkëjetesës, por dhe si mirënjohje për mbështetjen e dhënë për emigrantët e parë që zbarkuan në brigjet italiane pas viteve '90. Ndërsa pamjet nga shkolla shqipe në Bolonjë, nuk lënë hapësirë për komente. Është vërtetë një vepër me vlerë të madhe kombëtare. Një arritje e madhe për kombin dhe për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, përmes gjuhës shqipe. Projekti lindi nga komuniteti shqiptar që banon në këtë zonë, me mbështetje të shoqatave si "Korabi" drejtuar nga Astrit Poti, sipërmarrësve dhe aktorëve të shumtë, bashkëndarës të synimeve primare të kësaj nisme. Vizita në kompaninë e biznesit të vëllezërve Poti në Bolonjë të Italisë, për mua do të mbetet në kujtesë si një model, se si duhet të punojnë shqiptarët kudo ku janë për të treguar se janë aty, se janë vizionarë, se janë të guximshëm dhe se dinë çfarë bëjnë në çdo kohë, vend e situatë. Ndërsa shoqata "Korabi" është mendoj sinonim i forcës dhe vizionit kombëtar shqiptar, duke hedhur shikimin larg, për të krijuar një perandori humane, kulturore dhe kombëtare. Shumë mirënjohje vëllezërve Poti, që më krijuan këtë mundësi, për të njohur edhe veprimtaritë të tilla që na bëjnë krenar.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



UEFA e dyfishon shpërblimin për Kampionatin Evropian për Gra

NION, 16 DHJETOR - Shpërblimi për Kampionatin Evropian 2025 për Gra do të jetë dyfish më i lartë sesa në turneun e kaluar, ka njoftuar UEFA të hënën. Në Evropianin e vitit të ardhshëm, 16 ekipe kombëtare do t'i ndajnë 41 milionë euro. Çdo

federatë do t'i fitojë të paktën 1.8 milion euro për pjesëmarrje në Euro 2025 në Zvicër, si dhe është e detyruar t'ua ndajë të paktën 30 për qind të atyre parave futbollisteve të veta, njoftoi shtëpia e futbollit evropian. Fituesja e Euro 2025

do t'i marrë deri në 5.1 milionë euro. Klubet, futbollistet e të cilave do të garojnë në këtë turne, gjithashtu do t'i fitojnë rreth 6 milionë euro, apo 657 euro në ditë për futbolliste. Kjo është një rritje e përgjithshme prej 33-përqindësh krahasuar

me Evropianin e kaluar për gra. Shpërblimi për Kampionatin Evropian 2024 për burra ishte 331 milionë euro, nga të hyrat e përgjithshme prej rreth 2.4 miliard eurosh. Secila nga kombëtares pjesëmarrëse i fitoi të paktën 9.25 milionë euro,



ndërsa fituesja, Spanja, i mori 28.25 milionë euro.

Green, MVP i javës në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Java e 12 në ProCredit Superligë solli disa përballje mjaft interesante. Sfida më dramatike ishte në Prizren, në mes të Bashkimit dhe Golden Eagle Yllit, që është vendosur në çastet e fundit. Takimi ishte me kthesa, ku të dy skuadrat dhanë maksimumin, por që përfundoi me fitoren e mysafirëve. Më i miri te therandasit ishte Quade Green me 30 pikë, dy kërcime, dy asistime, duke treguar lojë të mirë, sidomos në çastet vendimtare. Derbin e rivalëve të vjetër e fitoi Peja ndaj Sigal Prishtinës, ku te verdhezinjtë u dalluan Jonathan Galloway me 11 pikë, 18 kërcime dhe një

asistim, si dhe Tristan Ikpe me 11 pikë, nëntë kërcime dhe dy asistime. Vëllaznimi shënoi fitore të rëndësishme ndaj Borës, ku te kuqezinjtë më i miri ishte Jason Jitoboh me 14 pikë, pesë kërcime dhe një

asistim. Trepça brenda dhjetë ditësh fitoi ndaj Proton Cable Prizrenit, kësaj radhe në elitë, ku te mitrovicasit Dardan Kapiti kishte dyshifrorë të dyfishtë prej 11 pikëve, dhjetë kërcimeve dhe një asistim.

MVP	
Quade Green (Golden Eagle Ylli)	30 pikë, 2 kërcime, 2 asistime, 22 indeksi
Top pesëshja	
Quade Green (Golden Eagle Ylli)	30 pikë, 2 kërcime, 2 asistime, 22 indeksi
Jonathan Galloway (Peja)	11 pikë, 18 kërcime, 1 asistim, 25 indeksi
Jason Jitoboh (Vëllaznimi)	14 pikë, 5 kërcime, 1 asistim, 23 indeksi
Tristan Ikpe (Peja)	11 pikë, 9 kërcime, 2 asistime, 22 indeksi
Dardan Kapiti (Trepça)	11 pikë, 10 kërcime, 1 asistim, 21 indeksi



Shabani: Na mungoi fati, por nuk dorëzohemi

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Selektori i Kosovës në hendboll (femrat), Agron Shabani, pranon se kundërshtari i raundit të dytë kualifikues për Kampionatin Botëror 2025 është i nivelit më të lartë. Por Shabani ka premtuar angazhim maksimal dhe përkushtim deri në fund në mënyrë që Kosova të paraqitet me dinjitet. Shorti i tërhequr të dielën në Vjenë ka përcaktuar që Kombëtarja jonë të përballlet me Suedinë. Ndeshjet janë në prillin e vitit të ardhshëm.



Suedia ishte kundërshtarja më e fortë e mundshme në short. "Na mungoi fati. Do ta kemi përballë një kundërshtar që është në radhën e ekipeve më të forta evropiane. Vazhdimisht po e kalojmë fazën e parë, kurse nuk po kemi fat me kundërshtarin direkt për kualifikim. I gjithë ekipi do të mundohemi që me dinjitet ta paraqesë shtetin tonë. Do të japim maksimumin, ndonëse përballë do ta kemi një kundërshtar shumë të fortë. Si Kombëtare do ta vazhdojmë zhvillimin. Nuk dorëzohemi, vazhdojmë drejt qëllimeve që i kemi për rritje të vazhdueshme. Janë sfida që do t'u qasemi me synim për të dhënë maksimumin dhe për ta kërkuar rezultatin maksimal të mundshëm", ka theksuar Shabani.

U godit me karrige në Beograd, Balaj: Serbinë duhet ta lëmë jashtë Botërorit



Tiranë, 16 dhjetor - Mes pamjeve të dhunës ekstreme në ndeshjen Serbi - Shqipëri 10 vjet më parë, bie në sy goditja ndaj ish-sulmuesit kuqezi Bekim Balaj. Në një intervistë për gazetarin e "Top Channel", Endi



Tufa, rikujton atë ngjarje të rëndë, ndërsa shpreh optimizëm se Kombëtarja jonë do t'ia dalë sërish në këtë përballje me Serbinë, me synimin për t'u kualifikuar në Kampionatin Botëror të

Futbollit. "Sa sheh shortin, na kthen edhe njëherë kujtimet, përballjen që kishim me Serbinë, një kundërshtar që ka ngarkesën e vet emocionale brenda. Sikurse u përballëm denjësisht atëherë, mendoj se çunat dhe grupi janë gati që të ripërballen me Serbinë. Atëherë e lamë jashtë Evropianit, këtë herë kërkojmë ta lëmë jashtë Botërorit. Në fund, sakrifica e Shqipërisë u shpërblye me kualifikimin në Kampionatin Evropian, shprehet Balaj. Skena dhune ndodhën në stadiumin e Beogradit me hyrjen e dronit të famshëm me flamurin "Autoktonus". E, megjithatë, një ngjarje shumë e rëndë për të cilën na u desh të kërkonim drejtësi nëpër gjykata për ta marrë të drejtën tonë që atëherë në kualifikoi për herë të parë në histori në një evropian.

Kampionet olimpike të xhudos i trajnojnë pjesëtarët e FSK-së

Pejë, 16 dhjetor - Në kuadër të programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos", në Qendrën Nacionale të Xhudos në qytetin e Pejës, është organizuar trajnimi për pjesëtarët e Forcës së

Sigurisë së Kosovës në fushën e xhudos, me fokus në avancimin e teknikave të xhudos dhe vetëmbrojtjes. "Ky program përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin dhe forcimin e

kapaciteteve të FSK-së, duke u bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes sportit të xhudos", thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës. Ky aktivitet

organizohet në bashkëpunim të Federatës së Xhudos të Kosovës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës.



Shehi: Jam befasuar për të mirë në Kosovë

SUHAREKË, 16 DHJETOR - Orges Shehi e mori drejtimin e Ballkanit duke e pasuar Artim Pollozhanin, i cili e pati një përvojë të shkurtër në Suharekë. Trajneri shqiptar thotë se ka mbetur i befasuar me kushtet dhe me

mirësjelljen që e hasi në Kosovë, ndërsa synon të ketë sukses në futbollin e Kosovës, pas përvojave që i pati në Shqipëri si trajner te Tirana, Partizani, Skënderbeu dhe te Kukësi. Në fundjavën që shkoi, Shehi e shijoi fitoren e

parë me kampionin e Kosovës duke e mposhtur Llapin (2-1). "Unë në Kosovë po bëj rreth 10 ditë, e kam marrë drejtimin e skuadrës dy ditë përpara se ta luanim ndeshjen e parë dhe dje ishte e dyta që arritëm ta fitonim

një ndeshje të rëndësishme. Është një përvojë e re pasi nuk kisha ardhur shpesh në Kosovë dhe jam surprizuar për mirë për sa i përket angazhimit të njerëzve, kushteve sa i përket mirësjelljes, mikpritjes dhe



jam shumë i befasuar për mirë për çfarë gjeta", ka deklaruar Shehi.

Triumfon Bostoni, lakersat rikthehen te sukcesi

UASHINGTON, 16 DHJETOR - Boston Celticsi triumfoi me rezultat 112-98 në fushën e Uashingtonit, duke forcuar pozitat në vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. Takim ku Celticsi diktoi në fushë, me 7 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Tatum me 28 pikë e 12 rebounde ishte më i miri për miqtë. Rikthehet te sukcesi edhe skuadra e lakersave, që mundi me rezultat 116-110 rivalët e Memphisit, në një ndeshje të ekuilibruar. Ndeshje magjike për Anthony Davisin, që realizoi 40 pikë e 16



rebounde, lider në fushë për kalifornianët. Pas një ndeshje spektakolare, ekipi i Dallasit fitoi me rezultat 143-133 ndaj Golden States. Shkëlqeu Luka Donçiq, protagonist me një "triple double" (45 pikë, 11 rebounde dhe 13 asistime), ndërsa 29 pikët e Wigginsit për

vendasit nuk mjaftuan. Jashtë fushës fitoi edhe Minnesota, që falë 26 pikëve të Edwardsit, mundi me shifrat 106-92 San Antonionin, ndërsa Phoenixi triumfoi me rezultat 116-109 ndaj Portlandit, e dallimin në fushë e bëri Devin Booker me 28 pikë.

REZULTATET

Indiana - New Orleans	119-104
Orlando - New York	91-100
Washington - Boston	98-112
San Antonio - Minnesota	92-106
Phoenix - Portland	116-109
Golden State - Dallas	133-143
Lakers - Memphis	116-110

Guardiola: Nuk jam mjaftueshëm i mirë

MANCHESTER, 16 DHJETOR - Pep Guardiola ka thënë se puna e tij te Manchester City nuk është e sigurt pavarësisht prej faktit që rinovoi së fundmi kontratën. "Qytetarët" kanë fituar vetëm një nga 10 ndeshjet në të gjitha garat, duke pësuar po aq humbje sa kishin pësuar në 105 ndeshjet e kaluara në total. Ata momentalisht gjenden nëntë pikë mbrapa liderit Liverpoolit në Ligën Premierë, teksa aspak mirë situata e tyre nuk është as në Ligën e Kampioneve pas humbjes me rezultat 2-0 nga Juventusi së fundmi. "Rezultatet nuk janë të mira, ndeshja nuk ishte e mirë. E di situatën, e kuptoj, por ky është realiteti. Ata duhet ta dinë se këto situata ndodhin. Brenda zonës ju duhet të jeni të kujdesshëm. Nuk ka të bëjë me Matheus



(Nunes). Ai ka luajtur me të vërtetë mirë në një pozicion që nuk është natyral për të. Nuk ka të bëjë me këtë, por ne duhet të luajmë më mirë. Ky rezultat do të na ndihmojë që të rikthehemi te më e mira, por momentalisht nuk e kemi këtë", ka thënë Guardiola.

"Unë nuk jam mjaftueshëm i mirë. Unë jam trajneri. Unë duhet të gjej zgjidhje dhe deri më tani nuk e kam bërë. Ky është realiteti. Ne duam të luajmë mirë, të krijojmë raste, por për momentin nuk është e mundur", ka shtuar Guardiola.

SHKURT

Ismajli, afër t'i bashkohet Napolit

Agjenti i Ardian Ismajlit ka folur për mundësinë që klienti i tij t'i bashkohet Napolit. "Jam duke biseduar me Napolin që një vit. Ai ka mundur të bashkohet janarin e shkuar", ka thënë agjenti i tij, Serxhio Mezi. "Ai ka mundur t'u bashkohet janarin e kaluar. Kemi diskutuar me drejtorin Mauro Meluso, dhe kemi punuar për një transferim të tillë me Ciro Palermon. Nuk e di nëse marrëveshja do të arrihet, por dy presidentët janë miqësorë, dhe mund të ndihmojnë në negociatë", ka shtuar ai. Sidoqoftë, mezi hodhi poshtë spekulimet se Interi dhe Juventusi e duan yllin e Shqipërisë. "Ai është lidhur [me një transferim te Juventusi dhe Interi], por nuk ka asgjë aty. Thiago Motta nuk e donte sa ishte te Bologna. Dyshoj që Bardh e Zinjt do ta ndjekin atë nëse po e kërkojnë një qendërbrojtës", ka deklaruar Mezi.

Broja: I kam shumë borxh Evertonit

Sulmuesi Armando Broja ka folur pas barazimit pa gola të Evertonit në "Emirates Stadium". Sulmuesi shqiptar ka lënë pas periudhën e errët të dëmtimeve duke u rikthyer në dispozicion të Shoj Dajsit. "Evertoni tregoi interes të fortë karshi meje, prandaj them jam borxhli karshi tij. Më ka ndihmuar shumë gjatë periudhës kur isha i dëmtuar dhe më ka bërë që të buzëqesh përsëri në fushë. Jam me fat që jam në një klub si Evertoni pasi më ka ndihmuar të rikuperohem", ka thënë sulmuesi shqiptar. "Për një futbollist fakti që zbret në fushë është gjithçka. Për mua ka shumë rëndësi që jam i shëndetshëm dhe që buzëqesh përsëri", ka shtuar Broja.

Wirtz, besnik i Leverkusenit

Ylli i Bayer Leverkusenit, Florian Wirtz, raportohet se ka vendosur të mbetet pjesë e Bayer Leverkusenit edhe për një kohë. Ai ishte synim i Real Madridit, Arsenalit dhe Bayern Munchenit, por duket se gjermani 21-vjeçar ka pëlqyer më shumë vazhdimin e kontratës me Leverkusenin. Kështu raporton e përditshmja gjermane "Kicker". Kontrata e tij aktuale skadon në vitin 2027 dhe ajo do të zgjatet edhe për një vit, ku talenti gjerman do të përfitojë edhe një rritje të konsiderueshme të pagës.

Verstappen: Këtë vit pata fat

Për të katërtën vit radhazi piloti holandez Max Verstappen shpallet kampion bote në Formula 1, një trofe i vështirë, por i merituar. Gjysma e parë e sezonit ishte ajo që i dha pilotit të Red Bullit titullin kampion, pasi në pjesën e dytë Verstappen u përpoq më së shumti ta mbrojë avantazhin e krijuar. "Ndonjëherë je me fat në jetë. Je në vendin e duhur, në kohën e duhur dhe padyshim si pilot në Formula 1 duhet të përfitosh nga e gjithë kjo. Për fat, ia dola mbanë. Katër tituj radhazi janë të pabesueshëm. Sigurisht që shpresoj të mos ndalem këtu dhe të arrij të njëjtat suksese për një periudhë më të gjatë kohore", ka thënë Verstappen. Më tej, holandezi ka shtuar: "Këtë vit konkurrenca ishte e madhe. Këtë gjë e pres edhe vitin tjetër. Megjithatë, në vitin 2026 shumë gjëra do të ndryshojnë dhe ndoshta shumë ekipe të tjera do të jenë ende konkurruese. Tani për tani mendoj se gjëja më e rëndësishme është ta shijojmë momentin dhe të jemi krenarë për atë që kemi arritur".

Dialo: Treguam se mund të fitojmë çdo ndeshje

Pa Amad Diallon, Manchester Unitedi e di se nuk do të kishte dalë fitimtar nga "Etihad". Lojtari më i mirë i ndeshjes është i kënaqur me fitoren e "Djajve" në fushën e rivalëve. "Ne donim ta

fitonim këtë ndeshje, nuk ishte e lehtë", ka thënë talenti i 20 herë kampionëve të Anglisë, i cili është një nga lojtarët më premtues të kësaj skuadre. "Në pjesën e dytë ne ushtruam mirë

presing, donim të fitonim dhe treguam se mund të fitojmë çdo ndeshje. Dua ta falënderoj Zotin për këtë. Le ta shijojmë sot dhe të presim me padurim ndeshjen e radhës", ka shtuar ai për

mikrofonat e "Sky Sports". "Ky është një derbi. Nëse e luan këtë ndeshje, qëllimi është vetëm ta fitosh atë dhe ne treguam se mund të fitojmë çdo ndeshje", ka shtuar mesfushori. Falë

kontributit të tij Unitedi fitoi një ndeshje jashtë në Premierë Ligë pasi humbi në pjesën e parë, për herë të parë që prej 9 majit 2021, kundër Aston Vilës (pas 17 ndeshjesh).

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SMART COM" D.O.O.- Btanch Office In Kosovo dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810802828 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitore në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SMART COM" D.O.O.- Btanch Office In Kosovo dega në Kosovë, u Prishtinu, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810802828 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "SMART COM" D.O.O.- Btanch Office In Kosovo dega në Kosovë, in Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810802828 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Ay Fimas" Sh.P.K me seli në Vushtrri, me pronar Nyrten Hajdari, ka marre vendim te shuajë biznesin me nrb UNIK: 811928647, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës se Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitore në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ay Fimas" D.O.O. od Vuçiterna, sa vlasnikom Nyrten Hajdari donelo odlukuo prestani rada sa nrb: 811928647, ujedno imenovao Likvidatorao sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Ay Fimas" L.L.C. with headquarters Vushtrria, majors Nyrten Hajdari, has come to the decision to quit its business: 811928647, the company has appointet a liguidator who is going to oversee the liguidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to showup within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM PËR ZVOGËLIM
TË KAPITALIT**

Bazuar në nenin 147 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, aksionari i shoqërisë

Valoni-Gergoc SH.P.K nga Gjakova, njofton mbi zvogëlimin e kapitalit të biznesit me numër UNIK: 810239881.

Based on Article 147 of Law no. 06/L-016 on Commercial Companies, the shareholder of the company

Valoni-Gergoc SH.P.K from Gjakova, announces the reduction of the capital of my business UNIQUE number: 810239881.

Na osnovu člana 147 Zakona br. 06/L-016 o privrednim društvima, akcionar kompanije

Valoni-Gergoc SH.P.K iz Đakovice, objavljuje smanjenje kapitala mog poslovanja JEDINSTVEN broj: 810239881

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nakije Juniku nga Gjakova shpall të gjata dhe të shkurtra. Informata në pavlefshme diplomën e sh.m.t. tel: 049\44-888-801 (viber) "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Tregti.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

